

Kosovë

Ekskluzive | Lamborghini ndalet nga Policia në Ferizaj, pasagjerit i gjendet pistoletë me 8 fishekë



Sinjali.com

10 Korrik 2026 21:55



Një kontroll rutinë i Policisë në Ferizaj ka rezultuar me sekuestrimin e një arme zjarri që ndodhej në posedim të pasagjerit të një veture luksoze Lamborghini, raporton Sinjali.

Burimet e **Sinjalit** bëjnë të ditur se rasti ka ndodhur pasditen e 9 korrikut, rreth orës 17:40, në rrugën “Enver Topalli” në Ferizaj.

Sipas informacioneve, njësia reaguese ka ndaluar automjetin për kontroll, ndërsa gjatë kontrollit të pasagjerit, **Valon Sadriut rreth 34-vjeçar**, është gjetur dhe sekuestruar një pistoletë e tipit “Zastava TT”, si dhe një karikator me tetë fishekë të kalibrit 7.62 mm.

Burimet e **Sinjalit** bëjnë të ditur se arma është konfiskuar në cilësinë e provës materiale, ndërsa i dyshuari është shoqëruar në stacion policor dhe është intervistuar lidhur me rastin.

Me autorizim të Prokurores kujdestare të Prokurorisë Themelore në Ferizaj, ndaj tij është iniciuar procedurë për veprën penale “Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve”.

Pas përfundimit të intervistimit, i dyshuari është liruar në procedurë të rregullt, ndërsa dosja e rastit do t’i procedohet Prokurorisë Themelore në Ferizaj për veprime të mëtejshme.

Shënim: Personat e apostrofuar në këtë artikull prezumohen të pafajshëm derisa fajësia e tyre të mos provohet me vendim të formës së prerë nga gjykata.

Sinjali – aty ku e vërteta flet para lajmit!

/GazetaSinjali/

Sinjali

Gazeta Sinjali mirëmbahet nga kompania "Sinjali" sh.p.k. Materialet dhe informacionet e Gazetës Sinjali nuk mund të kopjohen, të shtypen, ose të përdoren në çfarëdo forme tjetër, pa leje nga redaksia.



Lajme

Zgjedhjet 2026
Kosovë
Shqipëri
Rajon
Diasporë
Evropë
Botë

Aktualitet

Politikë
Drejtësi
Siguri
Shëndetësi
Arsim
Sociale

Hulumtime

Ekskluzive
Profile
Skandaloze

Ekonomi

Prodhime Vendore
Financa
Biznes

Sport

Botërori 2026
Futboll
Basketboll
Sporte Luftarake
Sporte të tjera

Showbiz

Bota e Yjeve
Modë & Stil
Bukuri dhe kujdes
Të tjera

OP-ED

Analizë
Kolumne
Intervistë

Jetë

Fitness
Ushqime
Travel
Këshilla
Receta
Dieta
Shëndeti

Kulturë

Film
Muzikë
TV & Radio
Libra
Art & Dizajn
Fotografi
Histori

Tech & Auto

Teknologji
Automjete
Telefona
Internet
Lojëra
Aplikacione

Fun

Qesharake
Kuriozitete
Kuize
Fakte
Të tjera